



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1193_08_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 17.09.2014

në seancën e mbajtur më datë 03 tetor 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHE** ankesa e konsumatorit B. G. me shifër DPR 46171 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1193_08_14 i datës 25.08.2014.

Arsyetim

Me datë 04.12.2013 Departamenti i Faturimit në KEDS i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2013 në vlerë financiare 845.67€. Pas kësaj fature të energjisë elektrike konsumatori me datë 18.12.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturën e periudhës nëntor 2013 për shkak të leximit jo të saktë dhe korrekt.

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 20.12.2013 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 62275943, ku TL=009244 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=002980 kWh (tarifa e ulët).

Me datë 01.11.2013 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike dhe procesverbalin nr. 0850482 e datës 08.01.2014, si dhe duke bërë korigjimin e faturave për periudhën 05/2013 deri më 11/2013 në vlerë -227.72€. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 25.08.2014 ka nxjerr vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.

Baza e kundërshtimit të konsumatorit se vendimi i DMK në ZRRE është vendim i padrejtë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se nuk është fabrikë prodhimi të paguajë vlera të larta të faturave të energjisë elektrike sepse ka një familje normale me harxhime normale. Në fund të



ankesës konsumatori thekson se kërkon që të vij një komision dhe të verifikojë gjendjen dhe të vëren se kjo nuk është normale.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03 tetor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se sipas procesverbalit të kontrollës nr. 0850482 të datës 20.12.2013 gjendja e evidentuar e njehsorit elektrik nr. 62275943 nga punëtorët e autorizuar të kontrollës në procesverbal përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit të periudhës 11/2013 dhe 12/2013, por që gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike të muajve të mëparshëm ka vërejtur se Departamenti i Faturimit në KEDS për periudha të gjata kohore nuk ka bërë lexim të saktë të shpenzimeve mujore, e që kjo ka ndikuar në grumbullimin e kilovatorëve të shpenzuar dhe faturimi i tyre në një faturë të vetme, siç është ajo e periudhës 11/2013.

Sa i përket pikës së konsumatorit se faturat e energjisë elektrike i ka të larta, Bordi i ZRRE gjatë analizës së bërë faturave të energjisë elektrike të kontestuara nga konsumatori ka vërejtur se gjatë periudhës 01/2013 e deri më 11/2013 Departamenti i Faturimit në KEDS nuk ka bërë faturim të rregullt, por konsumatorin gjatë kësaj periudhe e ka faturuar në mënyrë të vlerësuar dhe së gjithë shpenzimi për gjatë kësaj periudhe është faturuar në periudhën 11/2013 dhe atë si grumbullim i shpenzimit. Bordi i ZRRE-së thekson se nëse shpenzimin e energjisë elektrike të grumbulluar në periudhën 11/2013 e shpërndajmë proporcionalisht për gjatë periudhës 01/2013 – 11/2013 del se mesatarisht konsumatori ka shpenzuar nga 1040 kWh/muaj, e që është përafërsisht sa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 01/2011 deri më 07/2014 (duke mos e përfshirë periudhën 01/2013 – 12/2013) e që është 900 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së po ashtu ka analizuar edhe korrigjimin e bërë nga KEDS-i me datë 24.12.2013, ku konsumatori i është korrigjuar vlera prej -227.72€, dhe atë duke korrigjuar faturat e energjisë elektrike prej periudhës maj 2013 deri në nëntor 2013, dhe vlerëson se KEDS-i është dashur të korrigjoj konsumatorin nga periudha 01/2013 e deri më 11/2013 pasi që sipas analizave të shpenzimit ka rezultuar se gjatë kësaj periudhe konsumatori nuk ka pasur faturim të rregullt, por që edhe pas shpërndarjes së shpenzimit të energjisë elektrike për këtë periudhë prapë vlera e korrigjimit mbetet e pandryshuar.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03.10.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1193_08_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar